



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M  
NR. 277, Datë 12/12/2019

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 143 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë; nenit 9 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Vendimit Nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese; nenit 189/1/c të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”; nenit 8 të Regullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve” Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren znj. **Ermira Tafani**, si eksperte pranë Qendrës për Iniciativa Ligjore Tiranë për periudhën deri në fund të muajit shkurt 2020 në masën jo më shumë se 2 (dy) orë në javë gjatë dhe jashtë orarit të punës;
2. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) për prokuroren znj. **Ermira Tafani**, pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan, për periudhën mars-qershor 2020 në masën jo më shumë se 2 (dy) orë në javë gjatë orarit të punës dhe jo më shumë se 1 (një) orë në javë jashtë orarit të punës, në lëndën “E drejta procedurale penale” për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020;
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. **Ermira Tafani** dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR  
BESNIK CANI

ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
BUJAR SHESHI



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
VATË STAKA